



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT

Tiranë, më 22.01.2024

Lënda : Njoftim për shpallje konkursi për 1 (një) vënd të lirë pune për personel ndihmës akademik me karakter mësimor “Specialist/e”, në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit.

DREJTORISË SË ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE DIXHITALIZIMIT TË SHËRBIMEVE AKADEMIKO-SHKENCORE

K Ë T U

Universiteti i Sporteve të Tiranës, bazuar në Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UST-së, si dhe në Vendimin e Rektorit të UST-së, shpall kriteret për punësimin e 1 (një) punonjësi si personel ndihmës akademik me karakter mësimor, me kohë të plotë, “Specialist/e” në Departamentin e Rehabilitimit pranë Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

- I.** Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për pozicionin e punës si “**Specialist/e**” në Departamentin e Rehabilitimit pranë Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit si më poshtë;

Kriteret e përgjithshme:

- 1) Diplomimi në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës;
- 2) Kandidati duhet të zotërojë diplomë të ciklit parë dhe të dytë ose DIND (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi);
- 3) Të ketë përvojë të mëparshme pune;
- 4) Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- 5) Ndaj tij të mos ketë masa disiplinore në fuqi;
- 6) Të jetë i aftë për punë.

Kritere specifike :

1. Të ketë mbaruar studimet e larta universitare në nivelin “Bachelor” në Fizioterapi.
2. Të zotërojë programet bazë të kompjuterit.
3. Të zotërojë një nga gjuhët e Bashkimit Europian.
4. Të ketë të paktën një referencë nga punëdhënës të mëparshëm.

Kritere preferenciale :

1. Preferohen kandidatë me eksperiencë punë në IAL.
2. Të ketë eksperiencë pune në klinika dhe laboratore fizioterapie .
3. Të ketë licencë së profesionit të rregulluar të fizioterapisë.

Vlerësimi i Intervistës:

- Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:
 - a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.
- Vlerësimi i Kandidatit në Total është me 100 pikë, 30 pikë nga Intervista dhe 70 pikë nga kriteret e përcaktuara.

II. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
2. Një kopje jetëshkrimi;
3. Diplomë e shkollës së lartë dhe certifikatë notash e noterizuar;
 - Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë atë të njëjshuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
 - Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë atë të konvertuar sipas sistemit shqiptar;
4. Diploma e certifikata të ndryshme të kualifikimeve të noterizuara;
5. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj të noterizuar;
6. Dëshmi penaliteti/formular vetëdeklarimi;
7. Fotokopje e librezës së punës ose vërtetim nga institucioni ku ka punuar;
8. Referenca nga punëdhënës të mëparshëm;
9. Certifikatë personale.
10. Certifikatë familjare.

III. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurimit në njoftimin publik, dorëzohet me postë sipas afateve të shpallura:

- Dokumentacioni i dorëzuar me anë të shërbimit postar dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të këtyre kandidatëve.

IV. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit në faqen e Agjensisë së Prokurimit Publik.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, **specialiteti ku aplikon**, emri, mbiemri.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

- Kandidatët do të njoftohen me e-mail nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit për datën e zhvillimit të intervistës.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE ARKIV/PROTOKOLLIT